



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic Of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

1	Data	24.07.18	Vendi	Kaçanik
	Nj. org.	Numri	Shtojcë	
	01	3001-3169	/.	

KONTRATË PUNE

Komuna e Kaçanikut, përfaqësuar nga Shefket Koxha, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

"Loda Design" shpk me NRB 71249395 të cilën e përfaqson Valmir Azemi (me autorizim nr. 4012/2018) (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

"Ndërtimi i dhe asfaltimi i rrugëve në f. Gllloboqicë" me numër identifikues: 652/17/5582/521 (KA652/18/088/521).

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

"Ndërtimi i dhe asfaltimi i rrugëve në f. Gllloboqicë"

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: 39,995.50 €;
(Tridhjetenandemijëenatqindenantdjetëepesëeuro dhe 00/100€).

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

2.4 Punëdhënësi pajtohet ta paguaj kontraktuesin dhe atë: Në bazë miratimit të Menagjerit të Projektit vashtë nga ekzekutimi i punëve në teren pas raportit me shkrim nga ana e menagjerit të projektit, ndërsa situacioni perfundimtar paguhet pas raportit perfundimtar të menagjerit të projektit si dhe raport teknik të komisionit për pranim teknik të punëve.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);
- (f) (Procesverball i mbledhjes informative/vizitës së vendit)
- (g) Plani mbi menaxhimin e Kontrates.

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Numri i Prokurimit: KA652/18/088/521 Titulli "Ndërtimi i dhe asfaltimi i rrugëve në f. Gllloboqicë".

Neni 4

Komunikimet


4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Shefket Koxha
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	



Për Kontraktuesin

Emri:	Valmir Azemi
Pozita:	I Autorizuar
Nënshkrimi:	
Data:	24.09.2019
Vula:	



Numeri i Prokurimit: KA652/18/038/521 Titulli "Ndërtimi i dhe asfaltimi i rrugëve në f. Glloboqicë".

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- ose vendim nga gjyqi;
- kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrim.

PJESA III E KONTRATËS KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënime kursivo të përmendura për nënën përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni, Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë shqipe
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% e Vlerës së Kontratës apo 3,999.55€.
Përgjegjësia dhe i Sigurimi Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Implantëve dhe Materialeve [shëno shumat]; (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve [shëno shumat]; (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Implantëve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën [shëno shumat]; (d) dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: [shëno shumat] (ii) të personave të tjerë: [shëno shumat]
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 3 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periodha për Programin e azhurnuar është 45 ditë pune.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 27.09.2018 ku i gjith plani dinamik aratohet në ditar ndërtimor.
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë :
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% përqindjen e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	[Specifikoni nëse një regjister i punës nuk nevojitet].
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është Valmir Krasniqi
PParapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është:
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: Shuma, e specifikuar në KVK, do të ndalet nga çdo pagesë nga 10% e vlerës së pagesës së Kontraktuesit deri në përfundim të tërë të Punëve. Kjo shumë në asnjë rast nuk do të tejkaloj 10% e vlerës totale të kontratës origjinale.
Shkaqet kompensim për	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 3 tre ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periodha garantuese e defekteve është 365+30 ditë
Pagesa shkëputjes pas së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është 10% të

		<i>vleres se kontrates.</i>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	<i>[Specifikoni departamentin e Komisionit përgjegjës për pajtim]</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	<i>[shëno të dyja]</i> a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <i>gjykatën kompetent në pajtim me ligjin në Kosovë.</i> ose b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të <i>[specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes]</i> në pajtim me <i>[specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].</i>